



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2022:017950

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06001229

KPPP.nr.497/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Tobacco Holding Group” SH.P.K., me NRB: 70356272, me seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj km4, përfaqësuar sipas autorizimit nga Artan Qerkini, avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.T.SH. “Prishtina Events Managements”, me NRB: 70751763, me seli në Prishtinë, rruga “Nue Përllëshi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.1747/13 të datës 03.02.2014, të lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme e paraqitur nga debitori N.T.SH. “Prishtina Events Managements”, për shkak të mos ruajtjes së afatit për paraqitjen e prapësimit kundër Aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.1747/13 të datës 03.02.2014, të lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë si e pa afatshme.
- II. HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit N.T.SH. “Prishtina Events Managements”, i paraqitur kundër Aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.1747/13 të datës 03.02.2014, të lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, si i pa afatshëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar përmbarimin sipas Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.1747/13 të datës 03.02.2014, në bazë të dokumentit të besueshëm duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 8468 të datës 18.08.2012, dhe Faturës Nr.6398 të datës 29.06.2012, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 4,124.50 €, me kamatë ligjore, nga dita e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm ashtu që përmbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve, marrjen, regjistrimin dhe shitjen e sendeve të debitorit e deri në pagesën e kërkuar sipas propozimit për përmbarim.

Me kërkesën e kreditorit lënda është transferuar te përmbaruesi privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, i cili përmes konkluzionit P.nr.557/14 të datës 01.10.2014, ka njoftuar palët se procedura përmbarimore do të vazhdoj pranë përmbaruesit privat.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 09.03.2020, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, me arsyetimin se debitori deri me datë 29.01.2020, asnjëherë nuk ka qenë i njoftuar për procedurën përmbarimore ndërsa me datë 29.01.2020 përmes postës i ka pranuar të gjitha shkresat e lëndës, mirëpo i njëjti nuk ka qenë i njoftuar se ka të drejtë të paraqes prapësim. Tutje ka shtuar se mënyra se si përmbaruesi privat në konkluzionin P.nr.557/14, ka njoftuar debitorin vetëm se veprimet e ndërmarra nga gjykata do të jenë të vlefshme sikur të ishin ndërmarr nga përmbaruesi privat, e të cilat veprime nuk janë specifikuar dhe për të njëjtat debitori nuk ka qenë asnjëherë i njoftuar, për më tepër aktvendimi në formë të vulës me numër 1747/13 është plotësisht i padukshëm dhe në të nuk mund të identifikohet thujse asgjë e as këshilla juridike për paraqitjen e mjetit të rregullt, andaj debitori nuk e ka ditur se mund të paraqes prapësim. Po ashtu ka theksuar se debitori kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e paraqet brenda afatit ligjor pasi që i njëjti propozimin se bashku me shkresat e tjera e ka pranuar me datë 29.01.2020, dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 05.02.2020, andaj i njëjti kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqit brenda afatit prej 60 ditësh. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, të anuloj të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat, si dhe të lirohen llogarit bankare të debitorit.

Kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme ia ka bashkëngjitur edhe mjetin juridik të prapësimit, në të cilin ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit duke theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbarimore nuk ka tipare të përmbarueshmërisë pasi që e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, e njëjta nuk është nënshkruar e as vulosur nga ana e debitorit, andaj dhe urdhri përmbarimor është nxjerrë në mënyrë të jashtëligjshme. Tutje ka shtuar se procedura përmbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit andaj gjykata me rastin e shqyrtimit të prapësimit do të duhet të shqyrtoj faktin se dokumenti përmbarimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nëse i njëjti i plotëson kushtet për të qenë dokument i përmbarueshëm. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, të anuloj urdhrin përmbarimor si ta obligoj kreditorin që debitorit t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbarimore nuk është e përshtatshme sepse bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për LPP-në, e njëjta i përmban të gjitha kushtet për të qenë e përshtatshme për përmbarim pasi që e njëjta në mënyrë të rregullt është pranuar nga debitori, e njëjta është e nënshkruar nga debitori. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se urdhri përmbarimor është bërë i ekzekutueshëm në mënyrë të kundërligjshme, pasi që i njëjti është në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në fuqi. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit është e paafatshme për shkaqet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitorit Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.1747/13 i datës 03.02.2014 së bashku me konkluzionin P.nr.557/14 të datës 01.10.2014, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi, i janë dorëzuar me datë 29.01.2020, gjë e cila vërtetohet nga fletëkthesa e datës 29.01.2020, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Me dispozitën ligjore të nenit 130.3 të LPK-së është paraparë se pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme, ndërsa me dispozitën e nenit 509 është paraparë se në procedurën e zgjidhjes së

kontesteve tregtare vlen afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i LPK-së.

Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datë 29.01.2020, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur me datë 09.03.2020, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi dhe nga kjo arsye gjykata vlerësoi se kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme është e pa afatshme.

Meqenëse kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pa afatshme dhe marrë parasysh faktin se aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është dorëzuar tek debitori me datë 29.01.2020, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 30.01.2020, rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimit, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues”*, dhe atë jo më vonë se deri më 05.02.2020.

Andaj pasi që në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 09.03.2020, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me rreth një muaj vonesë.

Mbi këtë bazë, e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pa afatshëm.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 129, 130 dhe nenit 131 të LPK-së, e në lidhje me nenin 68.2 të LPP-së, nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.497/22, datë 31.07.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.